



# **STATUTI I KOMUNËS**

**Prizren, tetor 2008**

Në bazë të nenit 12, al. 2, pika a dhe al. 3 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Kuvendi i komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 15 tetor 2008, miratoi këtë

# **S T A T U T**

## **Seksioni I**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### Neni 1

Me këtë Statut, rregullohen përgjegjësitë, funksionet, organet dhe organizimi i brendshëm i Komunës.

Ky Statut përcakton:

1. Përgjegjësitë, kompetencat dhe funksionet e Kuvendit të Komunës;
2. Organet e Kuvendit të Komunës dhe Shërbimit Civil;
3. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
4. Administrimin financiar;
5. Konfliktin e interesave;
6. Pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, aktivitetin dhe mënyrën rreth vendosjes së punëve në kuadër të kompetencave të Komunës dhe
7. Dispozitat e veçanta.

## Neni 2

### **Përkufizimet**

Në këtë Statut, me nocionet si:

- a) “**Ligji**”, nënkuptohet Ligji i Vetëqeverisjes Lokale (LVL);
- b) “**Vetëqeverisje Lokale**”, nënkuptohen të drejtat dhe aftësitë e autoriteteve lokale të themeluara sipas ligjit në kuadër të kufizimeve që rregullojnë dhe drejtojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore;
- c) “**Komuna**”, nënkuptojmë komunën e Prizrenit si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë;
- d) “**Kuvendi i Komunës**”, është organi më i lartë përfaqësues i Komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur apo të emëruar si zëvendësime;
- e) “**Kryetari**”, është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës i cili zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta;
- f) “**Statuti i Komunës**”, është akti themelor që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe ligjet tjera në fuqi që i rregullojnë kompetencat e Komunës;
- g) “**Rregullorja e punës**”, është akt i cili miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që rregullon mënyrën e punës dhe të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe të komiteteve, komisioneve dhe trupave të tjera punuese që formohen nga Kuvendi i Komunës;
- h) “**Rregulloret Komunale**”, janë akte normative që në mënyrë të përgjithësuar rregullojnë një apo disa çështje nga kompetencat e Komunës para miratimit të së cilës konsultimi i publikut është i detyrueshëm;
- i) “**Vendimet**”, janë akte normative që i rregullojnë rastet konkrete dhe individuale për të cilat nuk është i detyrueshëm konsultimi i komiteteve dhe i publikut;

j) “**Vulat komunale**”, janë vula e rrumbullakët dhe vula e protokollit që i ka apo do t’i ketë në përdorim Komuna;

k) “**Struktura komunale**”, organet ligjvënëse dhe ekzekutive;

l) “**Komitet**”, nënkuptohen komitetet e përhershme dhe komitetet tjera;

m) “**Komisionet-Këshillat**”, nënkuptohen trupat punuese të përhershme apo të përkohshme që formohen nga Kuvendi;

n) “**Institucionet qendrore**”, janë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës;

o) “**Qeveria**”, nënkuptohet Qeveria e Republikës së Kosovës dhe

p) “**Ligjet**”, nënkuptohen ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### Neni 3

Komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejme Komuna), është njësi territoriale e vetëqeverisjes lokale në përbërje të Republikës së Kosovës e përbërë nga qytetarët me vendbanim të përhershëm të cilët e gëzojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës në territorin e përcaktuar me ligj si territor i Komunës së Prizrenit, e cila ushtron tërë pushtetin e vet që nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

### Neni 4

Komuna gëzon statusin e personit juridik dhe si e tillë ka të drejtë:

- të qeverisë me pasurinë e saj në pajtim me ligjet që janë në fuqi;
- të padisë dhe të paditet në organet kompetente të judikaturës;
- të ketë në pronësi apo bashkëpronësi ndërmarrje që janë në interes të përgjithshëm për qytetarët dhe
- të punësojë dhe të largojë shërbyesit civilë dhe punëtorët në pajtim me ligjet në fuqi.

Komunën, si person juridik e përfaqëson kryetari i Komunës, ndërsa në mungesë të tij dhe me autorizimin e kryetarit të Komunës e përfaqëson nënkryetari i Komunës ose personi i autorizuar nga ai, ndërkaq para organeve të judikaturës, Komunën e përfaqëson Avokati Publik Komunal ose i autorizuari i tij.

#### Neni 5

Selia e Komunës është në Prizren, në rrugën “Remzi Ademaj” dhe në rrugën “Adem Jashari”.

#### Neni 6

Komunën e përbëjnë: qyteti, fshatrat dhe lagjet urbane.

Në kuadër të territorit të komunës së Prizrenit janë këto fshatra-vendbanime (Në kllapa figurojnë emërtimet që janë në qarkullim), si

Billusha	(Kushtrimi)
Breg-Drini	(Breg-Drini)
Caparci	(Capari)
Dedaj	(Dedaj)
Dobrushta	(Mirëz)
Dojnica	(Dojnica)
Drajçiqi	(Drajçiqi)
Gërncari	(Gërncari)
Gornjasella	(Gornjasella)
Gorozhupi	(Gurishta)
Grazhdaniku	(Grazhdaniku)
Gjonaj	(Gjonaj)
Atmaxha	(Shkaba)
Hoça e Qytetit	(Hoça)
Jabllanica	(Jabllanica)
Jeshkova	(Gjeqi)
Kabashi	(Kabashi)
Kabashi i Hasit	(Kabashi i Hasit)
Karashëngjergji	(Shëngjergji)
Kobaj	(Kobaj)
Kojusha	(Kajusha)

Korisha	(Korisha)
Krajku	(Krajku)
Krusha e Vogël	(Dardhëza)
Kushtendili	(Kushnini)
Kushnini	(Kushnini i Hasit)
Landovica	(Landovica)
Leskoveci	(Arbëria)
Lezi	(Lezi)
Llokvica	(Llokvica)
Lubinja e Epërme	(Lubinja e Epërme)
Lubinja e Poshtme	(Lubinja e Poshtme)
Lybeqeva	(Malësia e Vërrinit)
Lubizhda	(Lugishta e Qytetit)
Lubizhda e Hasit	(Lugishta)
Lukinaj	(Lukinaj)
Lutogllava	(Legjenda)
Malësia e Re	(Pusi i Atit)
Manastirica	(Manastiri)
Mazrreku	(Mazrreku)
Medveci	(Ilirida)
Milaj	(Milaj)
Muradema	(Murademi)
Mushnikova	(Mushnikova)
Nasheci	(Syziu)
Nëpërgoshti	(Nebregoshte)
Novaka	(Novaku)
Novosella	(Novosella)
Petrovasella	(Theranda)
Pirana	(Pirana)
Planeja	(Planeja)
Pllanjani	(Pllanjani)
Poslishti	(Gurra)
Pouska	(Pouska)
Randobrava	(Qëndresa)
Reçana	(Reçani)
Romaja	(Ramaja)
Sërbica e Epërme	(Arbneshi)
Sërbica e Poshtme	(Arbanasi)
Skorobishti	(Shkorreti)
Smaçi	(Ardiana)

Srecka	(Srecka)
Struzha	(Sharri)
Shkoza	(Shkoza)
Shpinadia	(Shpenadia)
Trepetnica	(Mirdita)
Tupeci	(Tupeci)
Velezha	(Velezha)
Vërmica	(Drinasi)
Vlashnja	(Vlashi)
Zojzi	(Zogaj)
Zymi	(Zymi)
Zhivinjani	(Zhivinjani)
Zhuri	(Zhuri)

Ndryshimi i kufijve të komunës, mund të bëhet me kërkesën e Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Kufijtë Administrativë, pas konsultimit paraprak me qytetarët e komunës ose të komunave për të cilat kërkohet ndryshimi i kufijve.

#### Neni 7

Komuna ka emblemën, flamurin dhe simbolet e veta.

Emblema e Komunës është “Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit”, ndërsa në rreth do të jetë teksti “1878-Prizren”.

Përdorimi i simboleve të Komunës do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit.

#### Neni 8

Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit.

a) Vula e rrumbullakët ka këtë tekst:

Rrethi i parë: Republika e Kosovës;

Rrethi i dytë: Komuna e Prizrenit;

Rrethi i tretë: Emërtimi i Drejtorisë - Drejtoria e \_\_\_\_\_

Në mes të vulës është Emblema.

b) Vula e protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë me tekstin:

Emblema;  
Republika e Kosovës;  
Komuna e Prizrenit;  
Drejtoria e....  
\_\_\_\_. nr. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_.

Teksti i vulave të Komunës dhe organeve të saj, janë në gjuhët: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

#### Neni 9

Mënyra e mbajtjes dhe e përdorimit të vulave të Komunës përcaktohet me vendim të posaçëm të kryetarit të Komunës. Vulat përdoren vetëm për punë zyrtare të Komunës.

#### Neni 10

Kuvendi i Komunës ndan shpërblime, dekorata dhe mirënjohje.

Llojet e shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve, kushtet dhe mënyrën e ndarjes së tyre, i cakton me vendim të posaçëm Kuvendi i Komunës.

#### Neni 11

Në kufij dhe në territorin e komunës, pjesëtarëve të komuniteteve dhe bashkësive nacionale u garantohet e drejta e deklaramit të lirë lidhur me identitetin etnik, kulturor dhe fetar. Në territorin e komunës, gjuhë zyrtare janë: gjuha shqipe, gjuha serbe, gjuha boshnjake dhe gjuha turke. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me organet dhe shërbimet civile në komunë, në pajtim me ligjet dhe me konventat ndërkombëtare në fuqi.



## Neni 12

Pjesëtarët e komuniteteve pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet e Komunës në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Kosovës.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij dhe të gjitha tubimet publike mbahen në gjuhët: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës, shtypen në gjuhët: shqipe, serbe, boshnjake dhe turke; të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Komuna me kërkesën e palës, do të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës. Gjuha e palës është ajo sipas së cilës pala me kërkesë u është drejtuar organeve të Komunës.

Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike, janë në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke.

## Neni 13

Në organet dhe në shërbimet publike të qeverisjes lokale, sigurohet përfaqësimi proporcional i pjesëtarëve të komuniteteve kombëtare dhe bashkësive nacionale dhe gjinore, duke i respektuar dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.

## Neni 14

Komuna ka si festë publike 10 Qershorin – Ditën e mbajtjes së Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit dhe 12 Qershorin – Ditën e Çlirimit të Prizrenit.

## **Bashkëpunimi**

## Neni 15

Kuvendi i Komunës mund të bëjë marrëveshje bashkëpunimi me kuvendet e komunave të tjera të Kosovës në pajtim me dispozitat ligjore dhe me këtë Statut.

## Neni 16

Komuna, sipas nevojës, dhe në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, me qëllim të realizimit të punëve, në shërbim dhe në interes të përbashkët, mund të bëjë marrëveshje me komunat tjera për themelimin dhe mbikëqyrjen e përbashkët të ndërmarrjeve komunale që ofrojnë shërbime komunale për më shumë se një komunë.

Komiteti i Politikës dhe i Financave, Kuvendit të Komunës ia paraqet rekomandimet përkitazi me marrëveshjet që mund t'u nevojiten komunave për kryerjen e përgjegjësiave dhe kompetencave në bashkëpunim me komunat tjera.

Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë, do t'i caktojë anëtarët e këshillit në ndërmarrjet regjionale komunale, në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

## Neni 17

Komuna bashkëpunon dhe krijon partneritet me komunat tjera të Republikës së Kosovës brenda fushës së kompetencave të veta dhe të përcaktuara me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale.

Të gjitha marrëveshjet, sipas paragrafit të mësipërm financohen në bazë të buxhetit komunal dhe në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Komunal.

## Neni 18

Komuna mund të jetë anëtare e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## Neni 19

Komuna, në kuadrin e të drejtave dhe detyrave të veta dhe politikës së jashtme të caktuar të Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e ligjit dhe me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi apo të binjakëzohet me organet e pushtetit lokal të shteteve të tjera dhe të jetë anëtare e asociacioneve ndërkombëtare të pushteteve lokale.

## **Seksioni II**

### **Përgjegjësitë, funksionet dhe kompetencat e Komunës**

#### Neni 20

Komuna, në territorin e saj është përgjegjëse për veprimtaritë, si vijon:

1. Ofrimi i kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
2. Planifikimi urban i qytetit dhe i fshatit;
3. Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi;
4. Lëshimi i lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera;
5. Mbrojtja e mjedisit;
6. Zbatimi i rregullave ndërtimore dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimeve;
7. Mirëmbajtja e objekteve publike, ofrimi i shërbimeve publike e komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rrugët lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohjet lokale;
8. Veprimet emergjente, duke përfshirë shërbimet e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
9. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut;
10. Administrimi i pronës komunale;
11. Shkollimi parashkollor, fillor dhe i mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimorë;
12. Kujdesi parësor shëndetësor publik;
13. Shërbimet sociale dhe strehimi;
14. Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndeti publik;
15. Licencimi i ofruesve të shërbimeve publike, lëshimi i lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve, restorantet dhe hotelet;
16. Panairet dhe tregjet;
17. Emërtimi dhe riemërtimi i udhëve, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;

18. Sigurimi dhe mirëmbajtja e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
19. Turizmi;
20. Veprimtaritë kulturore, sportet dhe veprimtaritë tjera, veprimtaritë e rinisë, avancimi i ekonomisë dhe avancimi i vlerave qytetare, veprimtaritë tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për qytetarët e Komunës dhe për administrimin adekuat të territorit të komunës që nuk janë të përcaktuar me ligj.

Komuna, gjithashtu është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe urdhëresave administrative që janë në fuqi, duke përfshirë; regjistrat kadastralë, regjistrimin civil, regjistrin e votuesve, regjistrimin dhe licencimin e bizneseve, shpërndarjen e pagesave të ndihmës sociale dhe mbrojtjen e pyjeve në territorin e komunës, duke përfshirë edhe dhënien e lejeve për prerjen e drunjve në bazë të autorizimeve që delegohen dhe në pajtim me rregullat e miratuara nga qeveria.

Burimet përkatëse financiare për realizimin e qëllimeve të caktuara rreth përgjegjësive dhe kompetencave të bartura në pajtim me standardet dhe kërkesat e përcaktuara, do të sigurohen nga qeveria e Republikës së Kosovës.

## Neni 21

Kuvendi i Komunës, me Vendim të posaçëm rregullon numrin dhe organizimin e ofiqarive si degë të deleguara të administratës nëpër fshatra, në pajtim me nevojat dhe mundësitë e veta.

Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë do të rregullojë mënyrën e konstituimit, kompetencat, organizimin, financimin dhe mënyrën e caktimit të udhëheqësve të fshatrave, lagjeve, apo njësive tjera organizative të pushtetit në to. Ndër parimet për emërimin e udhëheqësve të fshatrave, lagjeve, apo njësive tjera organizative të pushtetit në to, do të jenë rezultatet nga zgjedhjet për pushtetin lokal.

## **Seksioni III**

### **Organet e Komunës dhe të Shërbimit Civil**

#### Neni 22

Komuna ka organet e veta, të cilat kryejnë funksionet e përcaktuara me ligje dhe me Statut.

Organet e Komunës janë, si Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Komuna bashkërendon punët dhe detyrat që i delegohen nga autoritetet qendrore të Kosovës.

#### Neni 23

Komuna ka edhe Avokaturën Publike, e cila punon në pajtim me Ligjin e Avokaturës Publike.

Emërimin e avokatit publik dhe zëvendësavokatit publik e bën Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin e Avokaturës Publike.

## **Kapitulli I**

### **Kuvendi i Komunës**

#### Neni 24

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i Komunës, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me kushtetutë, me ligj, me këtë Statut dhe me Rregulloren e punës.

Kuvendi zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet Komunale. Mandati i anëtarëve të Kuvendit, para nënshkrimit të betimit solemn, verifikohet nga ana e komisionit verifikues që themelohet nga Kuvendi i Komunës në seancën konstituive dhe është katërvjeçar, me përjashtim të mandatit aktual që është dyvjeçar.

Të drejtat e anëtarëve të Kuvendit, sipas këtij Statuti dhe sipas Rregullores së punës së Kuvendit, janë të barabarta për të gjithë.

Pushteti dhe përgjegjësitë e parapara me këtë Statut të Kuvendit të Komunës janë pa kufizime.

## **Kapitulli II**

### **Kompetencat e Kuvendit të Komunës**

#### Neni 25

Kuvendi i Komunës nuk mund të delegojë kompetencën e vet për marrjen e vendimeve lidhur me:

- a) miratimin e Statutit dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- e) themelimin e komiteteve dhe komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- f) zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.
- g) emërimin e nënkryetarit të Komunës për komunitete;
- h) nivelin e tarifave dhe i ngarkesave;
- i) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- j) emërimin dhe riemërimin e rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- k) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;

- l) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- ll) planifikimin urban dhe rural;
- m) bërjen e planeve dhe marrëveshjeve;
- n) përcakton llojet e shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve, kushtet dhe mënyrën e ndarjes së tyre dhe bën ndarjen e të njëjtave dhe
- o) përgjegjësitë tjera që kërkohen me ligj.

Me përjashtim të kompetencave të sipërpërmendura, për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë ndonjë kompetencë (autorizim) ndonjërit prej komiteve të Kuvendit të Komunës, kryetarit të Komunës ose personit tjetër nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

Kuvendi i Komunës, në çdo kohë mund të tërheqë autorizimin e dhënë me vendim.

Si shtesë e listës së kompetencave të padeleguara janë edhe miratimet e vendimeve si:

- a) që kanë të bëjnë me dhënien me qira të pronës së Komunës;
- b) plani i përgjithshëm strategjik – plani rregullues urban dhe hapësinor dhe ndryshimi i tyre;
- c) Themelimi i ndërmarrjeve publike komunale.

## Neni 26

Lidhur me ushtrimin e shërbimeve, Kuvendi i Komunës mund të delegojë përgjegjësi dhe autorizime për ushtrimin e kompetencave të Komunës nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje.

Për çdo vit fiskal, të gjitha marrëveshjet me fshatra, vendbanime dhe lagje, për mbikëqyrje të përbashkët të aktiviteteve të tilla të ndërmarra, duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës.

Të gjitha këto marrëveshje duhet të jenë me shkrim dhe nuk mund të jenë me kohëzgjatje më tepër se mandati i Kuvendit të Komunës. Marrëveshjet duhet të mbulojnë, pos tjerash: 1. Fondin; 2. Të ardhurat; 3. Shërbimet dhe 4. Administratën.

Menaxhimi i përbashkët për marrëveshjet e arritura, në pajtim me këto dispozita, zbatohen, pos tjerash, me një këshill të përbashkët mbikëqyrës, ndërsa Kuvendi i Komunës, emëron anëtarët e këtyre këshillave për t'i prezantuar dhe për t'i mbrojtur interesat e tij, duke shfrytëzuar mundësitë për realizim sa më të mirë.

## Neni 27

Kuvendi i Komunës, me qëllim të funksionimit sa më efikas, nga kompetencat e veta, nxjerr Statutin, Rregulloren e punës, rregulloret komunale, vendime, konkluzione, rekomandime dhe akte të tjera juridike nënligjore që janë në pajtim me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Komunës miraton Statutin. Kuvendi i Komunës në çdo kohë mund ta ndryshojë Statutin, nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm.

Çdo vendim për miratim apo për ndryshimin e Statutit duhet të miratohet me votat e më së paku dy të tretave të anëtarëve të Kuvendit.

Kuvendi i Komunës i miraton rregullat e procedurave dhe mund t'i ndryshojë ato nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullat e procedurës duhet të sigurojnë udhëheqjen dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të administratës së Komunës.

Vendimi për miratimin apo për ndryshimin dhe plotësimin e rregullave të procedurave dhe rregulloreve tjera, miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.

## Neni 28

Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës duhet të jetë në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Propozime për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund të bëjnë:



Kryetari i Komunës, 1/3 anëtarëve të Kuvendit ose njëri prej komiteteve të obligueshme, ose me iniciativën e qytetarëve në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit duhet të jenë me shkrim dhe duhet t'i drejtohen kryesuesit. Propozimet për ndryshim duhet të përmbajnë qartë hollësitë e ndryshimeve që propozohen. Kryesuesi, propozimet e bëra pas shqyrtimit, nëse janë të arsyeshme dhe në pajtim me ligjin, do t'ia propozojë për shqyrtim dhe miratim Komitetit të Politikës dhe të Financave.

Pavarësisht nga ajo që u tha, procedurat në vijim duhet të përcillen.

Propozimi për ndryshim duhet të miratohet nga ana e Komitetit të Politikës dhe të Financave, kështu që, propozimin për shqyrtim, Komiteti i Politikës dhe i Financave, do t'ia propozojë Kuvendit. Pas shqyrtimit, Kuvendi do të marrë vendim për miratimin apo refuzimin e propozimit.

Propozimi për ndryshimin apo për plotësimin, më pas do t'i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim paraprak. Nëse Kuvendi e miraton propozimin, përkatësisht propozimet, do të marrë vendim për fillimin e ndryshimit dhe plotësimin të Statutit me të cilin do ta obligojë komisionin e Statutit të hartojë projektpropozimin për ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në pajtim me vendimin e miratuar të Kuvendit, që do të shqyrtohen dhe do të miratohen në pajtim me procedurat e parapara.

Vendimin përfundimtar për miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit, Kuvendi e miraton pas përfundimit të konsultimit publik. Kuvendi i Komunës, pasi t'i vlerësojë të gjitha propozimet që ka pranuar, do të vendosë me votim se a do t'i miratojë ndryshimet.

Rregullat e procedurës mund të rregullojnë më tej procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Kuvendi i Komunës, vendimin për miratimin e Statutit apo ndryshimin dhe plotësimin e të njëjtit e merr me më së paku votimin e dy të tretës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

## Kapitulli III

### Mbledhja e parë dhe Betimi Solemn

#### Neni 29

Kuvendi i Komunës mban mbledhjen e parë inauguruese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Anëtari më i vjetër i Kuvendit i kryeson mbledhjet derisa kryetari ta ketë dhënë Betimin Solemn.

Mbledhja inauguruese e Kuvendit thirret nga kryetari, nëse është zgjedhur.

Nëse nuk është zgjedhur, apo për ndonjë shkak tjetër nuk e thërret mbledhjen, atëherë mbledhja inauguruese do të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit, brenda 15 ditësh nga data kur kryetari është dashur të thërrasë mbledhje inauguruese.

Nëse edhe anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen në mënyrën e paraparë me alinenë paraprake të këtij neni, atëherë mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të caktohet me nismën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nënshkruajnë Betimin Solemn. Forma e Betimit ose e deklaratës solemne është, si vijon:

“Beto hem se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të komunës së Prizrenit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

## **Kapitulli IV**

### **Mbledhjet dhe kryesimi i mbledhjeve**

#### Neni 30

Kryesuesi i Kuvendit thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi, me kërkesën e një të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit, ose me kërkesën e kryetarit të Komunës, mund të thërrasë në çdo kohë mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës. Rendi i ditës i propozuar në kërkesë për mbledhjet e thirrura në bazë të këtij neni, nuk mund të ndryshohet nga Kryesuesi dhe as nga pjesëmarrësit tjerë të Kuvendit.

Rregullat e procedurës rregullojnë gjithashtu çështjen e thirrjes dhe të udhëheqjes së mbledhjeve, nëse vendi i kryesuesit është i lirë, ose nëse për çfarëdo arsye nuk është në gjendje të marrë pjesë në mbledhje.

## **Kapitulli V**

### **Kuorumi dhe mbledhjet**

#### Neni 31

Kuorumi, për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, përbëhet nga më tepër se gjysma e anëtarëve të Kuvendit. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve, të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave *për* ose *kundër* ndonjë propozimi.

Kuvendi i Komunës dhe komitetet, marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut apo me rregullat e procedurës. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij merren me votën e shumicës së thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut.

## Neni 32

Kuvendi i Komunës duhet të mbledhet sa herë që është e paraparë me rregullat e procedurës, por duhet, së paku të mbajë dhjetë mbledhje brenda vitit fiskal prej të cilave pesë duhet të mbahen në gjashtë muajt e parë të vitit fiskal kalendarik vijues.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, gjithashtu mund të thirren me kërkesën e një të tretës së të gjithë anëtarëve të zgjedhur, ose me kërkesën e kryetarit të Komunës. Mbledhjet e kërkuara, nga anëtarët e Kuvendit duhet të caktohen në pajtim me rregullat e procedurës.

Kryetari i Komunës mund të thërrasë në çdo kohë brenda vitit fiskal mbledhje të jashtëzakonshme për të diskutuar për çështje urgjente. Mbledhjet e tilla të jashtëzakonshme, duhet të thirren në pajtim me rregullat e procedurës.

Më së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës, ose në raste urgjente, duke përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, tri ditë më herët, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe me rendin e ditës.

Njoftimet publike, me propozimin e rendit të ditës, duke përfshirë datën, orën dhe vendin e mbajtjes, duhet të shpallen në afatin e caktuar me alinenë e mëparshme të këtij neni. Nëse mbledhja është me dyer të mbyllura në pajtim me dispozitat e Rregullores dhe me Statut, njoftimi publik duhet të tregojë se mbledhja është e mbyllur për publikun.

Mënyra e punës dhe marrja e vendimeve nga ana e Kuvendit të Komunës, duhet të përcaktohen me rregullat e procedurës.

### Neni 33

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe mbledhjet e komiteteve, siç është paraparë në nenin 45 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, janë të hapura për publikun.

Kuvendi i Komunës, apo Komiteti, me votën e shumicës mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet:

- kur mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpjerë deri te një çrregullim publik ose dhunë;
- kur takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione dhe dokumente, të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare;
- kur kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale, ose
- kur ka informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

Në rastet e tilla, për vendimin e marrë njofton Kuvendi i Komunës.

Kur Kuvendi ose komitetet e tij mbajnë mbledhje me dyer të mbyllura, duhet të paraqesë shënime të hapura për publikun, të cilat tregojnë se është mbajtur mbledhja me dyer të mbyllura, datën dhe njoftimin që tregon se mbledhja është mbajtur në pajtim me dispozitat e nenit 45, al. 3 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

### Neni 34

Nëse Kuvendi i Komunës dështon lidhur me kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jofunksional dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton Komunën për dështimin dhe kërkon të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.

Kuvendi i Komunës konsiderohet jofunksional:

- nëse nuk e zgjedh kryesuesin tridhjetë ditë pas konstituimit;
- nëse nuk e miraton Statutin në afatin e paraparë sipas Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale;

- nëse nuk e miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës, ose
- nëse nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj.

Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e Komunës. Qeveria mund ta shpërndajë Kuvendin e Komunës jofunksional.

Zgjedhjet e reja për Kuvendin e Komunës mbahen në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Komunale.

## **Kapitulli VI**

### **Kryesuesi i Kuvendit si dhe Zëvendëskryesuesi nga radhët e komuniteteve pakicë**

#### Neni 35

Kuvendi ka kryesuesin, ndërsa nga radhët e komuniteteve pakicë, ka edhe zëvendëskryesuesin.

Kryesuesi thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit dhe të Komitetit të Politikës dhe të Financave, dhe në marrëveshje me kryetarin e Komunës cakton rendin e ditës për takimin e Kuvendit.

#### Neni 36

Kuvendi i Komunës, nga radhët e anëtarëve të vet, me vota të fshehta e zgjedh kryesuesin e Kuvendit.

Kandidaturat për kryesues, mund t'i dorëzohen Kuvendit me shkrim, pas propozimit të rendit të ditës për mbledhjen ku do të mbahen zgjedhjet, ose të prezantohen gojarisht në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të marrë më tepër se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Nëse asnjëri prej kandidatëve të propozuar nuk fiton më tepër se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të zgjedhur, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në rrethin e dytë të votimeve dhe për kryesues të Kuvendit do të zgjidhet kandidati i cili fiton më tepër se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit.

## **Kapitulli VII**

### **Zëvendëskryesuesi nga radhët e komuniteteve pakicë**

#### Neni 37

Kuvendi i Komunës ka edhe zëvendëskryesuesin për komunitete, të cilin post e mban kandidati përfaqësues i popullatës pakicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës.

#### Neni 38

Zëvendëskryesuesi i komuniteteve i Kuvendit të Komunës promovon dialog ndërkomunitar dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve pakicë në mbledhjet e Kuvendit.

Zëvendëskryesuesi i komuniteteve i Kuvendit të Komunës është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet ose vendimet e Kuvendit të Komunës të mos i shkelin të drejtat e tyre të garantuara kushtetuese.

Zëvendëskryesuesi i komuniteteve i Kuvendit të Komunës, për rishqyrtim, aktet apo vendimet e tilla ia paraqet Kuvendit të Komunës.

Në rast se Kuvendi i Komunës nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, çështjen që duhet shqyrtuar mund ta parashtojë në Gjykatën Kushtetuese.

#### Neni 39

Mandati i kryesuesit dhe i zëvendëskryesuesit nga radhët e minoriteteve është i njëjtë sikurse edhe i anëtarëve të Kuvendit.

#### Neni 40

Mandati i kryesuesit, do të pushojë me pushimin e mandatit të anëtarit në Kuvend, me dorëheqje ose me shkarkim nga ana e Kuvendit.

Procedura e shkarkimit do të jetë e njëjtë me procedurën e emërimit.

Mandati i zëvendëskryesuesit nga radhët e minoriteteve, do të pushojë sapo të pushojë mandati i anëtarit në Kuvend ose me dorëheqje.

#### Neni 41

Kuvendi ka Shërbimin Profesional, i cili do t'i kryejë punët profesionale administrative dhe punët tjera të Kuvendit dhe të komiteteve të obliguara.

## **Kapitulli VIII**

### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Kuvendit**

#### Neni 42

Në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kuvendit, secili anëtar ka të drejtë të marrë nismën dhe t'i bëjë propozime kryetarit të Komunës, nënkryetarit, nënkryetarit të komuniteteve, komiteteve, drejtorëve të drejtorive; t'u bëjë pyetje dhe të kërkojë informacione dhe sqarime, që nga organet e qeverisjes lokale dhe shërbimet profesionale, të kërkojë ndihmë profesionale dhe sqarime të duhura për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Kuvendit.



#### Neni 43

Asnjë anëtar i Kuvendit të Komunës nuk duhet të thirret në përgjegjësi penale e as të arrestohet, të paraburgoset ose të dënohet për mendimin e shprehur apo për votën e tij në Kuvend.

#### Neni 44

Mënyra e parashtrimit të pyetjeve dhe kërkesave nga ana e anëtarit të Kuvendit, do të rregullohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Përgjigjet jepen aty për aty, në mbledhjen e ardhshme, ose më së largu në afatin prej tridhjetë ditësh nga kryetari, kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i komuniteteve, udhëheqësi i Personelit ose drejtori kompetent, apo zyrtarët tjerë kompetentë për çështje përkatëse.

Informatat që i takojnë kategorive të përmendura në nenin 45, al. 3 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, do të jepen vetëm në kushte sipas të cilave ndalohet përhapja e tyre e mëtejme. Arsyet për masat e këtilla, do t'i bëhen me dije anëtarit dhe do të shënohen në dosje.

Pavarësisht nga ajo që u tha, pyetjet dhe kërkesat për informata të bëra në pajtim me këto dispozita, të cilat, nën një, prishin raportet, dhe nën dy, nuk janë në interes të përgjithshëm shoqëror, duhet të refuzohen.

#### Neni 45

Anëtarëve të Kuvendit u jepet librezë (karta) e identifikimit të këshilltarit. Përmbajtja, forma dhe mënyra e mbajtjes së evidencës së librezës së anëtarëve duhet të përcaktohet nga Kuvendi, ndërsa për procedurën e lëshimit, kujdeset Shërbimi Profesional për punët e Kuvendit.

Karta e identifikimit, në rast të pushimit të mandatit të anëtarit për çfarëdo arsye, mbetet pasuri e Komunës.

## Neni 46

Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:

- a) Nëse nuk e nënshkruan betimin ose deklaratën brenda një muaji pas zgjedhjes;
- b) Me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- c) Nëse ai ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- d) Nëse anëtari ia paraqet kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- e) Nëse anëtari është dënuar për ndonjë veprë penale me aktgjykim të plotfuqishëm me burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- f) Nëse anëtari nuk merr pjesë tre muaj rresht pa arsye në mbledhjet e Kuvendit të Komunës ose të komitetit ku është i emëruar;
- g) Nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm dhe
- h) Nëse me aktgjykim të plotfuqishëm humb aftësinë e veprimit.

Anëtari i Kuvendit të Komunës, në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## Neni 47

Anëtarët e Kuvendit, për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e komiteteve, duhet të lirohen nga ndërmarrja ose institucioni dhe nga vendi tjetër i punës ku ata janë në marrëdhënie të rregullt pune.

Anëtari i Kuvendit, anëtarët e komiteteve (komisioneve) të emëruara nga Kuvendi, duke përfshirë edhe kryetarin e Komunës, nënkryetarët, kryesuesin e Kuvendit dhe zëvendëskryesuesi, kanë të drejtë për kompensim për punën dhe aktivitetin e tyre.

Kompensimi për anëtarët e Kuvendit caktohet me vendim të posaçëm nga Kuvendi dhe ndahet nga buxheti i Komunës.

Çfarëdo kompensimi i tillë, duhet të jetë në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe udhëzimet e dhëna nga Autoriteti Qendror.

## **Seksioni IV**

### **Kapitulli I**

## **Kryetari dhe Nënkryetari**

#### Neni 48

Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët që kanë të drejtë vote në Komunë në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet Komunale që është në fuqi.

Kryetari i Komunës zgjidhet me mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit. Asnjë person nuk do të shërbejë më tepër se dy mandate si kryetar i Komunës.

## **Dhënia e Betimit**

#### Neni 49

Me rastin e zgjedhjes, kryetari i Komunës e bën Betimin Solemn përpara anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Forma e Betimit është, si vijon:

“Unë (emri dhe mbiemri) betohem se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Prizrenit, me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë”.

# Përgjegjësitë

## Neni 50

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës:

- a) Përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) Udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
- c) Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d) Është përgjegjës për zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Kuvendi i Komunës, administrimin financiar të Komunës dhe ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- e) Emëron dhe shkarkon nënkryetarin e Komunës;
- f) Rekruton dhe largon udhëheqësin e Personelit në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shërbimin civil;
- h) Në çdo kohë mund t'i propozojë drejtoritë që duhet t'i ketë Komuna;
- i) Emëron drejtorët e drejtorive të Komunës për të ndihmuar rreth kryerjes së detyrave të tij;
- j) Bën caktimin apo ndarjen dhe bashkërendimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësiive ndërmjet drejtorive sipas nevojës duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar;
- k) Emëron dhe shkarkon këshilltarët e tij të cilët i ndihmojnë atij për kryerjen e detyrave;
- l) Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- m) Propozon planin zhvillimor komunal, planet rregulluese dhe investuese, i propozon buxhetin vjetor për miratim Kuvendit të Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- n) Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
- o) Mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë ndonjë akt komunal që është miratuar nga Kuvendi para hyrjes së tij në fuqi kur konsideron se akti cenon interesin e komuniteteve apo ligjvënien që është në zbatim;

- p) Kujdeset për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe dispozitat tjera ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e komunave;
- r) Konsulton nënkryetarin e komuniteteve për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë;
- rr) Aktivitetet tjera që i caktohen me Statut;
- s) Bashkëpunon me kryesuesin e Kuvendit për caktimin e rendit të ditës për mbledhje të Kuvendit dhe
- sh) Kryen edhe të gjitha funksionet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta dhe përgjegjësi tjera që caktohen nga Kuvendi i Komunës për kryetarin në pajtim me këtë Statut.

#### Neni 51

Kryetari i Komunës, nga kompetencat e veta bie vendime, konkluzione, rekomandime dhe akte të tjera juridike nënligjore që janë në pajtim me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

## **Kapitulli II**

### **Nënkryetarët**

#### Neni 52

Kuvendi i Komunës ka nënkryetarin dhe nënkryetarin e Komunës për komunitete.

#### Neni 53

Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari.

Me kërkesë të kryetarit, nënkryetari i ndihmon kryetarit për ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe në mungesë të tij vepron në emër të kryetarit.

Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

## Neni 54

Me propozimin e kryetarit të Komunës, nënkryetari i komuniteteve do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetarit.

Emërimi dhe shkarkimi i nënkryetarit të komuniteteve propozohet nga kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet me votim nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm si dhe nga votimi i shumicës së të pranishmëve të anëtarëve të cilët i përkasin komuniteteve pakicë të Kuvendit të Komunës.

Nënkryetari i komuniteteve do t'i ndihmojë kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjen që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

Kur posti i nënkryetarit të komuniteteve mbetet i lirë, kryetari propozon nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë, emërimi i të cilit do të bëhet sipas procedurave të paragrafit 3 të këtij neni.

## Neni 55

Kuvendi i Komunës siguron mjete në buxhetin e Komunës për kompensimin e kryetarit, të nënkryetarit, për nënkryetarin e Komunës së komuniteteve pakicë, për kryesuesin, dhe për zëvendëskryesuesin nga radhët e komuniteteve pakicë në pajtim me ligjin në fuqi.

# **Kapitulli III**

## **Përfundimi i mandatit, shkarkimi dhe largimi i kryetarit të Komunës**

## Neni 56

Mandati i kryetarit të Komunës nuk mund të ndryshohet ose të ndërpritet para skadimit të mandatit të Kuvendit të Komunës, me përjashtim të arsyeve, si në vijim:

- a) Fitimit të statusit që e bën atë të papërshtatshëm për të qenë kandidat;
- b) Dënimit të tij në tri vjetët e shkuara për vepër penale për të cilin ai është dënuar me burgim prej gjashtë muajsh apo më shumë;
- c) Mungesës së paarsyeshme të kryetarit nga puna për më shumë se gjashtëdhjetë ditë;
- d) Vdekjes, paaftësisë mendore ose fizike të kryetarit ose
- e) Dorëheqjes së kryetarit.

Kryetari i Komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 ditësh, nëse kryetari ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra e kryetarit të Komunës, ministria përgjegjëse për pushtet lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e atij kryetari. Qeveria e Republikës së Kosovës, brenda 30 ditësh mund të suspendojë me vendim kryetarin e Komunës dhe t'ia dorëzojë lëndën gjykatës kushtetuese.

Nëse gjykata kushtetuese e përkrah vendimin, Qeveria mund të shkarkojë nga detyra kryetarin.

Qytetarët e Komunës mund të ndërmarrin nismën për largimin e kryetarit të Komunës.

Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzet për qind e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.

Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet.

## Neni 57

Mandati i nënkryetarit të Komunës për komunitete mund të përfundojë për arsyet e njëjta të parapara për kryetarin e Komunës.

Kryetari i Komunës mund të nisë procedurën e shkarkimit të nënkryetarit të Komunës për komunitete në rast të ekzistimit të arsyeve të bazuara për një gjë të tillë, e cila procedurë do të jetë e njëjtë si ajo e emërimit.

# **Seksioni V**

## **K o m i t e t e t**

## Neni 58

Kuvendi i Komunës, si komitete të përhershme, formon Komitetin e Politikës dhe të Financave, Komitetin e Komuniteteve, Komisionin e Statutit dhe Komisionin Verifikues të mandatit të anëtarëve.

Kuvendi i Komunës, në çdo kohë sipas nevojës mund të themelojë edhe komitete, komisione, këshilla apo trupa tjera punuese të përhershme apo të përkohshme dhe vendos për kompetencat dhe veprimtaritë e tyre.

Kuvendi i Komunës, në çdo kohë, sipas nevojës mund të themelojë edhe komitete këshillëdhënëse nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes

Gjatë caktimit të anëtarëve të komiteteve të përhershme dhe të komiteteve të tjera, Kuvendi i Komunës siguron përfaqësimin e entiteteve politike.

Komitetet e krijuara sipas këtij neni, përpos KPF-së, mund të kenë në radhët e tyre anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, por shumica e anëtarëve të komiteteve, patjetër duhet të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës.



Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i çdo komiteti zgjidhet nga mesi i anëtarëve dhe prej vetë anëtarëve të komitetit, përveç rasteve kur me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale apo me këtë Statut kërkohet ndryshe.

Kuvendi i Komunës mund t'i shtojë kompetencat dhe aktivitetet e këtyre komiteteve të obligueshme, nëse ato nuk janë në kundërshtim me ato të parapara me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale.

Kompetencat dhe aktivitetet e komiteteve tjera, do të jenë ato që do të caktohen me vendimin e Kuvendit të Komunës.

Çdo komitet vendos për kohën e mbajtjes së mbledhjeve në pajtim me rregulloren e punës.

Mbledhja e komitetit caktohet (thirret) nëse kryesuesi i komitetit mendon se kjo është e nevojshme ose me kërkesën me shkrim të së paku një të tretës së anëtarëve të tij.

## **Komiteti i Politikës dhe i Financave**

### Neni 59

Mbledhja e Komitetit të Politikës dhe të Financave thirret dhe kryesohet nga kryesuesi i Kuvendi të Komunës.

Përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e përafërt të subjekteve politike dhe komuniteteve etnike dhe gjinore që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës.

Për anëtarë të këtij Komitetit mund të zgjidhen (emërohen) vetëm anëtarët e Kuvendit.

### Neni 60

Komiteti i Politikës dhe i Financave, në pajtim me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe me këtë Statut, është përgjegjës:

- për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale nga kompetencat në pajtim me këtë ligj;
- shqyrton politikat fiskale dhe financiare;
- shqyrton planet dhe nismat qytetare;
- shqyrton planet zhvillimore strategjike të Komunës;
- shqyrton kornizën buxhetore vjetore dhe afatmesme;
- shqyrton planin vjetor të prokurimit publik;
- shqyrton rregulloret për tatimet, tarifat dhe ngarkesat e ndryshme komunale;
- shqyrton planin vjetor dhe raportin e punës së auditorit të brendshëm;
- propozon në rast nevojë rishikimin e buxhetit gjatë vitit fiskal;
- shqyrton raportin e kryetarit në pajtim me këtë Statut dhe
- ushtron edhe kompetenca të tjera të cilat i delegohen nga Kuvendi i Komunës.

#### Neni 61

Komiteti i Politikës dhe i Financave nuk është organ vendimmarrës, me përjashtim në rastet kur për një gjë të tillë autorizohet nga Kuvendi, ndërsa funksionin e vet e ushtron në formë të rekomandimeve, vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të caktuara.

## **Komiteti i Komuniteteve**

#### Neni 62

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti, gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Komiteti i Komuniteteve përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, ndërsa anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë, përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në Komitetin e Komuniteteve. Përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në Komunë, përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.

## **Seksioni VI**

### **Administrata komunale**

#### Neni 63

Administrata e Komunës organizohet përmes drejtorive.

Çdo drejtori e Komunës menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari.

Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtorinë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret e Komunës në fuqi.

Drejtorët, për çështjet që u përkasin atyre, i raportojnë rregullisht kryetarit dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

#### Neni 64

Drejtorët mund të largohen nga posti me dorëheqje ose mund të shkarkohen nga ana e kryetarit të Komunës, apo kur pushon nevoja për atë post.

# Shërbimi Civil i Komunës

## Neni 65

Organizimi i brendshëm i drejtorive dhe sistemimi i shërbyesve civilë, në vende të punës bëhet me akt të veçantë sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në drejtoritë e komunës së Prizrenit.

Gjatë marrjes së ndonjë vendimi sipas këtij kapitulli, Kuvendi i Komunës do të udhëhiqet nga parimet e efikasitetit dhe ekonomizimit dhe do të sigurojë të bëhet një sigurim adekuat buxhetor për vendime të qëndrueshme.

## Neni 66

Konfliktet rreth kompetencave ndërmjet zyrtarëve të lartë të Komunës të cilët janë emëruar nga kryetari, i zgjedh kryetari.

Zyrtarët e lartë të zgjedhur ose të emëruar në bazë të konkursit, mund të shkarkohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil.

## Neni 67

Personeli i administratës, përbën Shërbimin Civil të Komunës, që i përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- kryetarit, nënkryetarëve dhe drejtorëve të Komunës dhe
- kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kushtet për punësim në Shërbimin Civil të Komunës do të jenë të atilla që lejojnë përzgjedhjen e personelit me kualifikim adekuat dhe me përvojë. Ky objektivi duhet të arrihet, përveç masave tjera, duke u dhënë përparësi kandidatëve të kualifikuar dhe me përvojë të duhur, njëherësh, duke u ofruar mundësi trajnimi pas punësimit dhe perspektivë për karrierë.

Punësimi në Shërbimin Civil të Komunës, do të mbikëqyret dhe rregullohet nga kryetari i Komunës përmes udhëheqësit të Personelit për të

siguruar që shërbimi të reflektojë proporcion të drejtë të përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

Secila drejtori siguron përfaqësimin gjinore dhe të komuniteteve në të gjitha fushat dhe nivelet e Shërbimit Civil të Komunës.

Shërbimi Civil i Komunës, kryen detyrat dhe obligimet në mënyrë korrekte dhe të paanshme, duke respektuar palën dhe duke vepruar në pajtim me ligjin.

Personeli i Shërbimit Civil të Komunës, rekrutohet në punë përmes konkursit publik.

Të gjithë nëpunësit e Shërbimit Civil të Komunës, i përfillin dhe i zbatojnë urdhrat e epiorëve të tyre, përveç në ato raste kur urdhrat e tyre janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Nga të gjithë nëpunësit civilë të Komunës, kërkohet t'i paraqesin me shkrim të gjitha konfliktet e interesit në një regjistër të cilin e ruan udhëheqësi i Personelit.

#### Neni 68

Drejtorët e Komunës, drejtorët e institucioneve dhe të ndërmarrjeve nën autoritetin e Komunës dhe nëpunësit civilë të administratës së Komunës, nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo të Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

## **Seksioni VII**

### **Administrimi financiar**

#### Neni 69

Buxheti i Komunës, duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në parime objektive.

Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për veprimtaritë ekonomike brenda vitit fiskal dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës. Komuna në buxhetin e vet, gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

Statuti dhe Rregullorja e Punës i përcaktojnë procedurat buxhetore, standardet financiare dhe rregullat e prokurimit që i plotësojnë parimet e parapara me ligjet në fuqi.

## Neni 70

Për buxhetin e Komunës, të hyrat sigurohen nga:

- 1) Autoriteti Qendror;
- 2) Të hyrat vetjake të Komunës (në këtë kontekst të hyrat vetjake të Komunës duhet t'i përjashtojnë fondet e siguruar, nën 1 si më lart;
- 3) Mjetet shtesë nga autoritetet qendrore për kompetencat e shtuara dhe të deleguara;
- 4) Grantet e jashtëzakonshme;
- 5) Donatorët ndërkombëtarë;
- 6) Nga kontributi i vetë qytetarëve si dhe
- 7) Burimet legjitime që janë të lejuara me ligjet në fuqi.

## **Të hyrat nga Autoriteti Qendror Fiskal**

### Neni 71

Qeveria, përmes Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë bën transferime financiare për Komunën, duke u bazuar në parime objektive, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për çdo komunë dhe prioritetet e shpenzimeve të përcaktuara sipas ligjit në fuqi.

## **Të hyrat vetjake të Komunës**

### Neni 72

Komuna krijon të hyra vetjake në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Pushtetit Qendror, duke përfshirë mënyrat në vazhdim:

- 1) Licencat dhe pagesat që i cakton Komuna;
- 2) Të ardhurat nga pasuria e Komunës;
- 3) Gjobat dhe përqindja e gjobave;
- 4) Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës së Komunës;
- 5) Interesi në depozitat komunale;
- 6) Të hyrat nga tatimi në pronë dhe taksat tjera që lejohen me ligje të caktuara nga Komuna dhe
- 7) Shitja e pronës komunale.

### Neni 73

Në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Ligjin për Financat Lokale, Komuna ka të drejtë, të marrë hua (kredi) bankare për investime kapitale për nevojat e Komunës.

## **Të hyrat nga donatorët**

### Neni 74

Për ta ndihmuar zhvillimin e Komunës, donatorët ndërkombëtarë mund të derdhin mjetet në buxhetin e Komunës.

Nëse donatorët derdhin mjete në buxhetin e Komunës me përkushtim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.

Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në buxhetin e Komunës.

## **Të hyrat nga vetëkontributi**

### Neni 75

Për t'i përmbushur më mirë apo për t'i përmirësuar nevojat e qytetarëve, Komuna mund të sigurojë mjete edhe përmes vetëkontributit dhe deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve në pajtim me ligjet e zbatueshme. Mjetet e siguruar në këtë mënyrë, mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklarimit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me vetëkontributin, më afër definojnë me ligj dhe me vendim për zbatimin e kontributit.

### Neni 76

Komuna zotëron në mënyrë të pavarur të hyrat që i takojnë.

Për mënyrën e përdorimit të mjeteve, Kuvendi i Komunës duhet të vendosë në pajtim me ligjet e zbatueshme, me rregullat dhe me rregulloret sipas propozimit të kryetarit, pas shqyrtimit nga ana Komitetit të Politikës e të Financave.

### Neni 77

Buxheti i Komunës miratohet për një vit fiskal. Viti fiskal fillon më 1 janar.

Kryetari i Komunës, pas njoftimit për lartësinë e fondit të ndarë nga pushteti qendror për vitin vijues, ia paraqet Komitetit të Politikës e të Financave propozimbuxhetin për shqyrtim, duke propozuar që i njëjti, pas shqyrtimit nga Komiteti i Politikës e i Financave, sa më shpejt që është e mundur t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe për miratim.



## Neni 78

Komuna e publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës. Raporti i prezantohet Kuvendit të Komunës për miratim, jo më vonë se deri më 30 maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e Komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për atë vit fiskal. Raporti duhet të sqarojë mënyrën e financimit të secilës nga veprimtaritë dhe duhet të tregojë gjendjen financiare të Komunës në fund të atij viti fiskal. Ai duhet të përfshijë edhe deklaratat për kontrollet financiare. Këto kërkesa duhet të përfshijnë edhe veprimtaritë e ndërmarrjeve të Komunës, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe marrëveshjet e bëra (të lidhura) me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Raporti vjetor për buxhetin, në pajtim me dispozitat e ligjit duhet të publikohet në fund të çdo viti fiskal.

Komiteti i Politikës dhe i Financave është përgjegjës të sigurojë raportin vjetor, dhe atë, për shqyrtim dhe miratim t'ia paraqesë Kuvendit të Komunës, në pajtim me dispozitat e zbatueshme të ligjit.

Për të përmbushur këtë përgjegjësi, Komiteti i Politikës dhe i Financave, merr këto masa:

- 1) Në çdo buxhet të përgatitur në përputhje me ligjin dhe urdhëresat administrative për zbatimin e ligjit, fut synimet e Komunës në lidhje me secilën veprimtari për të cilën është përgjegjëse Komuna;
- 2) Rishikon synimet në mënyrë të vazhdueshme;
- 3) Krijon procesin për monitorimin e punës në lidhje me synimet;
- 4) Identifikon nevojat aktuale dhe të parashikuara si dhe mënyrat me të cilat ato përmbushen;
- 5) Deklaron se përmbajtja është në pajtim me dispozitat ligjore.

Raportin vjetor e miraton Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të kryetarit të Komunës pas shqyrtimit nga ana e Komitetit të Politikës dhe të Financave, më së largu deri më 30 maj të vitit vijues.

Raporti duhet të përmbajë:

- a) Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara;
- b) Realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre;
- c) Mënyrën dhe lartësinë e financimit të veprimtarisë së caktuar;
- d) Gjendjen financiare në ndërmarrjet e Komunës, buxhetin e të cilave e miraton dhe e kontrollon Kuvendi i Komunës dhe
- e) Të dhënat tjera të parapara me ligj dhe akte të tjera nga lëmi i financave.

#### Neni 79

Varësisht nga dispozitat ligjore që i rregullojnë shërbimet publike, duke përfshirë udhëzimet administrative që lëshohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komuna do të miratojë buxhetin e ndërmarrjeve komunale që kryejnë shërbime komunale. Buxheti i propozuar nga ndërmarrjet komunale, duhet të përfshijë lartësinë e tarifës së propozuar për shërbimet që i kryen ndërmarrja dhe të dhënat tjera të parapara me ligj.

Propozimi i buxhetit duhet t'i dorëzohet Kuvendit për miratim më së largu deri me 1 dhjetor, para vitit të ardhshëm fiskal.

#### Neni 80

Komuna e kontrollon dhe e mbikëqyr afarizmin financiar të ndërmarrjeve publike komunale dhe të gjitha organizatat jofitimprurëse, të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna.

## Neni 81

Autoriteti Qendror, siç parashihet me ligjet që janë në fuqi, cakton revizorë të pavarur financiarë me qëllim të kontrollimit të veprimtarive financiare në Komunë.

Çdo revizor i caktuar ka të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera, dhe mund të kërkojë ndonjë informatë, të cilat atij ose asaj i duhen për kryerjen e kontrollit.

Varësisht nga dispozitat që rregullojnë shërbimet publike, duke përfshirë udhëzimet administrative që lëshohen nga Departamenti i Shërbimeve Komunale ose Departamenti i Shërbimeve Publike, revizori kontrollon gjithë afarizmin – veprimtarinë financiare të ndërmarrjeve komunale, në bashkëveprim me kontrolluesit komunalë.

Revizori inspekton tërë veprimtarinë financiare të të gjitha organizatave jofitimprurëse, të cilat marrin ndihmë financiare nga Komuna së bashku me kontrolluesit komunalë.

Çdokush mund të paraqesë deklarime të mbikëqyrësi lidhur me veprimtarinë financiare dhe çështjet tjera financiare të Komunës.

Revizori mund të vendosë lidhur me hetimin e deklarimeve.

Revizori i dorëzon Kuvendit raport me shkrim për çdo kontroll financiar, për të cilin Kuvendi i Komunës merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin. Kuvendi nuk mund ta refuzojë asnjë prej rekomandimeve pa arsye të mjaftueshme dhe arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

## Neni 82

Komuna ka Zyrën e Auditorit të Brendshëm që funksionon në pajtim me ligjin në fuqi.

# **Seksioni VIII**

## **Konflikti i interesave**

Neni 83

### **Konfliktet e interesit të anëtarëve të Kuvendit**

Anëtari i Kuvendit të Komunës apo anëtari i Komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ka interes personal apo material.

Çdo anëtar duhet t'i paraqesë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo anëtar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

Para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mban Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare sapo ato të ndodhin.

Neni 84

### **Konfliktet e interesit të kryetarit të Komunës**

Menjëherë pas zgjedhjes së tij, kryetari i Komunës ndërpret çdo kontratë apo marrëveshje që ka, e cila mund ta vërë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar.

Nga kryetari i Komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

Kryetari i Komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i Komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

Nëse Kryetari merr ndonjë vendim nga kompetencat e veta ku ka ose ka pasur konflikt interesi, vendimi i tillë do të jetë i pavlefshëm.

Këto dispozita të Statutit lidhur me çështjet e konfliktit të interesave, do të zbatohen edhe për nënkryetarët.

#### Neni 85

### **Konfliktet e interesit të drejtorëve të drejtorive të Komunës**

Drejtorët përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështje për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.

Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi të shfaqen.

Nëse drejtori merr ndonjë vendim nga kompetencat e veta ku ka ose ka pasur konflikt interesi, vendimi i tillë do të jetë i pavlefshëm

#### Neni 86

Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij ka interes personal ose financiar.

#### Neni 87

Me rastin e pranimit të funksionit, dhe për çdo ndryshim eventual që ndodh gjatë mandatit, çdo anëtar i Kuvendit dhe funksionar i lartë i Komunës, obligohet të bëjë deklaratë paraprake, me shënime të plota në regjistër për interesat e tyre financiare. Për regjistrat në fjalë, për anëtarët e Kuvendit do të kujdeset Shërbimi Profesional i punëve të Kuvendit; për zyrtarët e lartë do të kujdeset kryetari i Komunës, ndërsa për Personelin do të kujdeset shefi i Personelit.

Pa e kufizuar atë që u tha në përgjithësi, kur një drejtor ka konflikt interesi, kryetari do të kryejë rolin e tij që ka të bëjë lidhur me çështjen e caktuar që ky rol të ushtrohet nga vetë ai, ose të ushtrohet nga ana e ndonjë drejtori tjetër që vepron nën mbikëqyrjen e tij.

Neni 88

Përfundimi nga procedurat e marrjes së vendimeve të zyrtarëve të përmendur, mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose me vendim të shumicës së atij kuorumi ose me kërkesë të palës së tretë, nëse personat e përmendur janë drejtpërdrejt të përfshirë në atë çështje e cila mund të shpjerë deri te konflikti i interesave.

Për të gjitha rastet që nuk janë rregulluara me këtë nen, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative.

## **Seksioni IX**

### **Kapitulli I**

#### **Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në mbledhje, veprimtaria dhe mënyra e vendosjes në punët publike**

Neni 89

Në pajtim me rregullat e procedurës, qytetarët në Komunë mund t'i propozojnë për shqyrtim çështjet me interes publik përmes konsultimeve dhe mund të marrin pjesë drejtpërdrejt në tubime, varësisht nga dispozitat e këtij Statuti.

## Neni 90

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve, Komuna mund të përdorë mekanizmat e realizimit, si:

1. Fushatën informative dhe ato të publicitetit për promovimin e programeve dhe veprimtarive komunale;
2. Kontakte me qarqe të zgjedhura për ta vënë në sprovë dhe për të diskutuar politikën;
3. Anketa lidhur me zbatimin e politikës, ku do të përfshiheshin përveç tjerash, informues të veçantë, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo;
4. Shpallje publike të propozimeve lidhur me politikën apo projektregulloren, duke ftuar pjesëmarrjen me prezantime;
5. Kontakte me rëndësi me grupe përkatëse të interesit;
6. Takime publike;
7. Seanca publike;
8. Hulumtime të opinionit publik;
9. Komitete këshillëdhënëse;
10. Referendumet në pajtim me nenet 98-101 të këtij Statuti.

Në çdo rast do të jepet një arsyetim i bazuar për zgjedhjen e mekanizmave të konsultimit, apo pjesëmarrjes publike dhe do të lejohet një afat kohor i mjaftueshëm për paraqitjen e propozimeve.

Rezultatet do të merren parasysh dhe do të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar.

## Neni 91

Kuvendi i Komunës, komitetet dhe komisionet e tij, para miratimit të rregulloreve komunale, mbajnë konsultime publike, duke i ofruar publikut informata të nevojshme për propozime. Shpallja publike e propozimeve dhe diskutimi për to, zhvillohet së paku katërmbëdhjetë ditë.

## Neni 92

Komuna, së paku dy herë në vit duhet të organizojë tubime publike me qytetarët.

Në tubimet publike, përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

Tubimet janë të karakterit të hapur dhe mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit, varësisht nga dispozitat e këtij Statuti.

Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin nisma, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara në pajtim me dispozitat e Statutit.

Njëra prej këtyre mbledhjeve do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, ndërsa tjetra do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit fiskal.

Nëse mbledhjet publike mbahen gjatë vitit fiskal, atëherë duhet të ketë një ndërkohë prej së paku dy muaj ndërmjet mbledhjeve. Tubimet e tilla mund të organizohen nëpër fshatra, lagje dhe vendbanime të caktuara.

Tubime të tilla nuk mund të caktohen pas datës së shpalljes së zgjedhjeve.

Koha, dita dhe vendi ku mbahet tubimi publik shpallet përmes mjeteve të informimit publik, dhe atë dy javë para mbajtjes së tubimit.

Shpalljen publike e bën Komuna.

Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

### Neni 93

Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson kryetari i Komunës ose personi i autorizuar nga ai.

Kryetari i Komunës ka të drejtën të caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë të ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund të refuzojë, të thërrasë ose të dëgjojë folësit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund të imponojë kufizimin e përgjithshëm të kohës së lejuar për fjalime.



Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, pyetje për të cilën aty për aty nuk mund të jepet përgjigje, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigjen me shkrim brenda 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit.

#### Neni 94

Për çdo tubim publik mbahet procesverbali i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimi ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna i shqyrton Komiteti i Politikës dhe i Financave në afat prej 60 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e ardhshëm.

#### Neni 95

Çdo qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë me vetiniciativë, përmes formës së petitionit t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e rregulloreve dhe akteve tjera me të cilat zgjidhen çështje të rëndësishme për qytetin, fshatin, lagjen, vendbanimin, në pajtim me ligjet dhe me Statutin në fuqi.

Subjektet e përmendura, mund t'i drejtojnë petition Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij në mënyrë të pakufizuar e që kanë të bëjnë me:

1. Rregullimin e qytetit, të fshatit dhe të lagjes;
2. Mirëmbajtjen e infrastrukturës në territorin e Komunës ose të një pjese;
3. Urbanizimin e qytetit dhe të fshatrave;
4. Mbrojtjen e mjedisit jetësor;
5. Organizimin e referendumit dhe
6. Çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

Një nismë e tillë e subjekteve, fillon me nënshkrimin e tyre në formë të petitionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes kryesuesit të Kuvendit.

Çdo petition duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit, emrat dhe adresat e nënshkruesve, si dhe lëndën e petitionit.

Një petition i cili nuk përmban elementet e duhura të përmendura më lart, nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

#### Neni 96

Kryesuesi i Kuvendit, çdo petition të vlefshëm ia prezanton Kuvendit të Komunës në afat prej 45 ditësh nga dita që ai e pranon. Kuvendi i Komunës, petitionin dhe rekomandimet lidhur me të mund t'ia referojë për shqyrtim paraprak një komiteti të caktuar.

Në mbledhje të komitetit, me rastin e shqyrtimit, parashtruesi i petitionit ka të drejtë të marrë pjesë në pajtim me rregullat e procedurës.

Vendimin përfundimtar për çështjen e petitionit e merr Kuvendi i Komunës në afatin prej 45 ditësh nga dita e prezantimit të petitionit në Kuvend.

Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'u kumtohet parashtruesve të petitionit.

#### Neni 97

Qytetarët mund të marrin nismë për të propozuar rregullore brenda kompetencave të Komunës për miratim nga Kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në fuqi.

Propozuesit, Draftin e rregullores së propozuar ia dorëzojnë kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Draftirregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.

Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

# Kapitulli II

## Referendumi

### Neni 98

Qytetarët mund të kërkojnë që përmes referendumit, drejtpërdrejt të vendosin në bazë të deklarimit për aktet me karakter të përgjithshëm të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës ose për miratimin e ndonjë akti për çështjet e caktuara që janë në interes të përgjithshëm për qytetarët e tërë territorit apo për një pjesë të territorit të Komunës.

Përderisa çështjet me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me kompetencat e Komunës, për të cilat Kuvendi i Komunës për arsye të ndryshme ka marrë vendim përfundimtar, atëherë qytetarët e pakënaqur me të, mund të kërkojnë vlerësimin për hedhjen e atij vendimi në referendum.

Referendumi, në nivel të Komunës mund të organizohet me nismë të Kuvendit të Komunës dhe me vetë nismën e 10 përqindëshit të qytetarëve me të drejtë vote të regjistruar në listat e votimit në zgjedhjet e fundit.

Kërkesa për shqyrtimin e aktit të përgjithshëm të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës, për të cilën kërkohet shqyrtimi (deklarimi) në referendum, i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të aktit për të cilin kërkohet mbajtja e referendumit.

Vendimin për shpalljen e referendumit e miraton Kuvendi i Komunës me shumicë votash të anëtarëve pjesëmarrës.

### Neni 99

Çdo propozim për organizimin dhe zhvillimin e referendumit, përcillet me një arsyetim të bazuar, së bashku me:

- pyetjen e parashtruar për vendimin që kërkohet përgjigjja e cila mund të jetë, po ose jo;

- vlerësimin për shpenzimet dhe burimet e mjeteve;
- nënshkrimet, emrat e plotë dhe adresat e parashtruesve që bëjnë kërkesën për organizimin e referendumit kur Kuvendi i Komunës nuk vepron me vetiniciativë;

- Kuvendi i Komunës, me vendimin e vet, cakton datën se kur do të mbahet referendumit;

- zhvillimin e referendumit e mbikëqyr një komision profesional i pavarur që emërohet nga Kuvendi i Komunës.

#### Neni 100

Referendumi mund të organizohet dhe të shpallet për tërë territorin e Komunës ose për disa fshatra apo lagje.

Referendumi nuk mund të përsëritet për një çështje të caktuar pa kaluar një vit nga mbajtja e referendumit paraprak, në rastet kur ka të bëjë me nenin 75 të këtij Statuti dhe periudhës kohore prej gjashtë muajsh para skadimit të mandatit të anëtarëve të Kuvendit, apo pasi të shpallet data për mbajtjen e zgjedhjeve komunale.

#### Neni 101

Referendumin e udhëheq komisioni për zbatimin e referendumit që emërohet prej Kuvendit të Komunës. Komisioni i emëruar për zbatimin e referendumit do të emërojë këshillat votues.

Rezultatet e referendumit publikohen në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së tij.

Referendumi do të konsiderohet i suksesshëm në qoftë se për propozim votojnë më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm e qytetarëve që votojnë në mjedisin ku organizohet referendumit.

## **Seksioni X**

### **Akti formal, dokumentet zyrtare dhe informatat**

Neni 102

“Akti formal”, domethënë vendim i vetëm i marrë nga Komuna dhe ka pasoja ligjore për një ose më shumë persona fizikë apo juridikë.

Përveç në raste urgjente, arsyetimi për të gjitha aktet formale, duhet t'i komunikohet me shkrim palës në kohën kur është kryer veprimi formal. Në raste urgjente, arsyet do të jepen gojarisht kur është e praktikueshme dhe të komunikohen me shkrim sa më shpejt që është e mundur. Parimet e përpjesëtimit dhe të mirëbesimit duhet të qeverisin në ndërmarrjen e të gjitha akteve formale.

Pala duhet të informohet me shkrim për çdo të drejtë për ankesë dhe për procedurën e shqyrtimit që ekziston në lidhje me veprimet formale. Kjo informatë do të jepet kur akti formal është kryer ose në rast urgjent, sa më shpejt që është e mundur.

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve të Komunës, do të shqyrtohen sipas Ligjit të Procedurës Administrative.

Të gjitha kontratat, marrëveshjet dhe dokumentet tjera zyrtare të Komunës, duhet të nënshkruhen nga kryetari ose nga personat e autorizuar që të veprojnë në emër të tij.

Kryetari do ta vërë në dispozicion të publikut tërë materialin publik ku përshkruhen detyrat dhe kompetencat e Komunës, organizimin e brendshëm dhe mënyrën se si publiku mund të shfrytëzojë shërbimet që ofrohen.

Të gjitha dokumentet mund të shikohen nga palët e interesuara gjatë orarit të punës në pajtim me dispozitat e ligjit për qasje në dokumente zyrtare, me përjashtim të atyre rasteve kur me ligj kërkohet ndryshe.

Të gjitha shkresat dhe kumtesat zyrtare që i lëshon Komuna, do të kenë emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të punës të personit që i ka lëshuar dhe që mund të ofrojë informata më të hollësishme lidhur me çështjen në fjalë.

Personi që dëshiron ta kontrollojë një dokument, duhet të tregojë të dhëna të mjaftueshme në mënyrë që të mundësohet identifikimi i dokumentit, dhe varësisht nga kërkesa, atij do t'i tregohet vendi ku mund ta gjejë dokumentin.

Personi që shikon dokumentin, do të ketë mundësi ta bëjë një kopje të dokumentit për shfrytëzimin e vet. Komuna mund ta lëshojë një kopje dhe të kërkojë një tarifë që nuk tejkalon çmimin e kopjes.

Nëse një person dëshmon se, dokumenti të cilin e mban Komuna përmban shënime të gabueshme, ai do të ketë të drejtë të kërkojë që ato informata të përmirësohen falas.

Rastet të cilat nuk janë të përfshira në këtë nen, i nënshtrohen dispozitave të ligjit për qasjen në dokumente zyrtare.

## **Seksioni XI**

### **Dispozitat e veçanta**

Neni 103

Ky Statut do të hyjë në fuqi pas tetë ditësh, pas nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Që nga dita e miratimit të këtij Statuti, në afat jo më shumë se 120 ditë, do të bëhet harmonizimi i rregulloreve dhe i të gjitha akteve tjera të Komunës me këtë Statut.

104

Ky Statut mund të plotësohet dhe të ndryshohet në pajtim me dispozitat e Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe të këtij Statuti.

Asnjë nga dispozitat e Statutit nuk duhet të veprojë në drejtim të ndryshimit, plotësimit, modifikimit të ndonjë dispozite të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale. Në rast kolizioni, atëherë vlejné dispozitat e Ligjit.

## Neni 105

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Statuti, pushojnë së vepruari të gjitha dispozitat dhe aktet komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe me këtë Statut.

## Neni 106

Me asnjë dispozitë të akteve që do të miratohen në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, nuk mund të parashihet veprimi retroaktiv i të njëjtave, nëse do të jenë në dëm të palëve.

## Neni 107

Interpretimi i këtij Statuti, duhet të udhëhiqet nga fryma dhe synimi i Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

Në rast konflikti gjatë interpretimit të këtij Statuti, meritohet do të jetë teksti i këtij Statuti në gjuhën shqipe.

Që nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Statuti, do të pushojë së vepruari Statuti nr. 01/011-76 i datës 9 gusht 2001.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 01/011-5643

Më 15 tetor 2008

Kryesuesi i Kuvendit  
Nijazi Kryeziu